



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e mërkurë, në datën 21 shkurt 2018, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar
Zylyftar	BREGU	Anëtar

AMA, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Dhënien e licencës private kombëtare të transmetimit audio analoge, shoqërisë “Club Muzikor” sh.a., të përbërë nga licenca e shërbimit të programit audio “Club FM Radio” dhe licenca për ndërtimin e operimin e rrjetit analog, për të mbuluar me sinjal audio, territorin e Republikës së Shqipërisë”. **(Vendimi nr. 26, datë 21.02.2018)**
2. “Emërimin e zonjës Vera Muço në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, në Autoritetin e Mediave Audiovizive”. **(Vendimi nr. 27, datë 21.02.2018)**
3. “Përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio të komunitetit dhe çeljen e garës për dhënien e licencës të transmetimit audio të komunitetit”. **(Vendimi nr. 28, datë 21.02.2018)**
4. “Çeljen e procedurës së dhënies së 16 licencave të transmetimit audio analoge private”. **(Vendimi nr. 29, datë 21.02.2018)**
5. “Pajisjen me licencë shërbimi programi audiovizivn “TV Berati” dhe kalimin e të drejtave të licencës së subjektit person fizik Artur Shehu tek subjekti person fizik Alban Shehu”. **(Vendimi nr. 30, datë 21.02.2018)**
6. “Pajisjen me licencë për shërbimin e programit audioviziv “Tv Glob” të subjektit person fizik Emiljano Hoxhaj”. **(Vendimi nr. 31, datë 21.02.2018)**
7. “Pajisjen e shoqërisë “MRM” sh.p.k., me licencë për shërbimin e programit audioviziv “Tv Lobi”. **(Vendimi nr. 32, datë 21.02.2018)**
8. “Pajisjen e shoqërisë “UTV Education” sh.p.k., me licencë shërbimi programi audioviziv “Tv UTV Education”. **(Vendimi nr. 33, datë 21.02.2018)**
9. “Pajisjen e shoqërisë “Tv 5 Monde” sh.a., me licencë për ritransmetimin e shërbimit të programit audioviziv “Tv 5”. **(Vendimi nr. 34, datë 21.02.2018)**
10. “Heqjen e autorizimit të subjektit person fizik Bajram Skraqi, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Fier-Shegan” **(Vendimi nr. 35, datë 21.02.2018)**

11. “Heqjen e autorizimit të subjektit person fizik Ladimir Fiska, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor XH&L”. **(Vendimi nr. 36, datë 21.02.2018)**
12. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit, gjobë nr. 629, datë 05.06.2013, të vendosur ndaj subjektit person fizik Arjan Xhani”. **(Vendimi nr. 37, datë 21.02.2018)**
13. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit, gjobë nr. 68, datë 21.07.2017, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj subjektit person fizik Shkëlqim Bylykbashi, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv me kabëll Arbër”. **(Vendimi nr. 38, datë 21.02.2018)**

Po ashtu në këtë mbledhje, AMA ra dakord që subjekteve:

- Personit fizik Edlira Vogli, për subjektin audioviziv privat vendor “Tv Klaudiana”;
- Shoqërisë “RTV Adriamed” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Durrësi”; dhe subjektin audioviziv privat vendor “Tv Adriamed”;
- Shoqërisë “4 Plus Media Group” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “Tv 4+”;
- Shoqërisë “6+1 Vlora” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “Tv 6+1”;
- Shoqërisë “AVN” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “TV AVN”;
- Shoqërisë “Vlora Channel” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “Vlora Channel”,

t’u caktojë si afat përfundimtar për shlyerjen e plotë të detyrimeve financiare, **datën 31 mars 2018.**

Tiranë, 21 shkurt 2018

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**